



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 242/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.07.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e shoqërisë “Laser Med” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr.REF-56393-04-17-2020, me objekt: “*Set per CT-Skaner*”, Loti 3, me fond limit 2.875.000 leke pa tvsh, zhvilluar me date 11.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan.

**Ankimues:** “Laser Med” sh.p.k  
Autostrada Tiranë-Durrës, Mbikalimi i Rinasit, km 5 Kashar, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan.  
Drejtoria e Spitalit, Elbasan

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 21.04.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-56393-04-17-2020, me objekt: “*Set per CT-Skaner*”, Loti 3, me fond limit 2.875.000 leke pa tvsh, zhvilluar me date 11.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan.

II.2. Në datën 15.05.2020 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar. Nga vlerësimi i bërë nga KVO-ja rezulton si më poshtë:

- |                          |                                 |
|--------------------------|---------------------------------|
| 1. “Laser Med”sh.p.k     | 1.450.805,50 lekë, skualifikuar |
| 2. “Fedos” sh.p.k        | 1.552.500,00 lekë, skualifikuar |
| 3. “Saer Medical” sh.p.k | 2.185.000,00 lekë, kualifikuar  |

Operatori ekonomik “Laser Med” sh.p.k është njoftuar nga KVO për arsyet e skualifikimit të tij si më poshtë:

*1.Kontratrat e ngjashme të paraqitura nga ju nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit për lotin 3 .*

2. Vërtetimi i debisë për OSHE i paraqitur nga ju nuk është i saktë edhe pas kërkesës së dërguar nga AK për dokumentacion justifikues me mesazh në rrugë elektronike dt 12.05.2020 nuk keni dërguar përgjigje, duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim të kapacitetit teknik pika 2.3.1 dhe pika 2, dh, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

II.3. Në datën 18.05.2020, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në SPE dhe ankimuesi është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tij si vijon:

1. Vërtetimi i debise per OSHE i paraqitur nga ju nuk eshte i sakte, pasi ju si operator pjesemarres duhet te kishit dokumentuar ne vertetim nga OSHEE per detyrime te operatorit Megapharm shpk ne baze te kontrates huaperdorje (neni 3 detyrime ndaj te treteve) paraqitur nga ana juaj, duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim te kapacitetit teknik pika 2 dh te kerkuara ne DST.
2. Mostra e paraqitur nga ju , sipas komisionit te testimit te mostrave nuk jane te pranueshme per perdorim ne pajisjen e injektorit te kontrastit ne Spitalin Elbasan.

II.4. Në datën 21.05.2020, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

“ [...]

Ne proceduren e prokurimit publik Kerkese per Propozim te zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor: Qendra Spitalore "Dr.Xhaferr Kongoli", Elbasan, me objekt "Blerje Materiale Mjekimi" (marreveshje kuader, me afat 24 muaj), ndare ne tre lote, me fond Limit/Vlera e pritshme e kontrates 3.898.000 (tremilion e teteqind e nentedhete e tetemije) Lek pa TVSh, oferta e Laser-Med shpk per Lotin 3 - Set per CT-Skaner eshte skualifikuar me arsyetimin, se:

“Kontratat e ngjashme te paraqitur nga ju, nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit per lotin 3.

Vërtetimi i debise per OSHE i paraqitur nga ju nuk eshte i sakte, edhe pas kerkeses se derguar nga AK per dokumentacion justifikues me mesazh ne rruge elektronike dt 12.05.2020 nuk keni derguar pergjigje, duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim te kapacitetit Teknik pika 2.3.1 dhe pika 2.dh te kerkuara ne DST.”

1- Ne piken 2.3.1 te Dokumentave te Tenderit, nga autoriteti kontraktor kerkohet: "Furnizime te meparshme te ngjashme ne nje vlere prej 40% te vleres se fondit limit" te lotit apo shumes se loteve per te cilat konkurron, te realizuara gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave te kesaj procedure prokurimi”.

Ne plotesim te kesaj kerkese nga Laseer Med shpk jane dorezuar Vërtetimet per realizim dhe Kontratat e realizuara me Qendren Kombetare te Transfuzionit te Gjakut, me objekt: "Blerje Reagente dhe aksesore te tjere te nevojshem per testimet ne laboratorin e imunoematologjise". Nga KVO eshte gjykuar se keto kontrata nuk jane te ngjashme me objektin e prokurimit, por duke mos sqaruar/arsyetuar se perse keto nuk jane te ngjashme, pra duke bere thjesht nje konstatim.

*Ne mungese te gjykimit te arsyetuar jemi te detyruar te paraqisim argumentat tona per te sqaruar ngjashmerine midis mallrave objekt prokurimi mes kontrates se shpallur nga AK dhe kontratave te paraqitur ne permbushje te pikes 2.3.1 te DT.*

*I.1. Nga KVO respektivisht AK, nuk eshte sqaruar, faktuar apo argumentuar se ku konsiston mosngjashmeria e kontratave, per rrjedhoje nuk mund te paragjykojme se ku eshte bazuar per te konsideruar si te pa vlefshem dokumentacionin e paraqitur per piken 2.3.1 te KVK. Kontratat e lidhura me QKT Gjakut dhe vertetimet e realizimit te tyre te paraqitura ne kete procedure prokurimi jane paraqitur edhe ne procedura prokurimi per pajisje, aparatura mjekesore dhe materiale mjekimi, edhe ne vitet e meparshme dhe nuk jane kontestuar nga asnje prej Autoriteteve kontraktore, c'ka prezumon se jane ne perputhje me kriteret e gjykimit dhe vleresimit te parashikuara nga aktet ligjore e nenligjore dhe pranuar si te tilla.*

*Duke gjykuar ne baze te parimeve dhe kriterëve te LPP, i cili si qellime, nder te tjera, ka edhe "te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit", si edhe "konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike", eshte vendosur dhe kriteri i eksperiencave te ngjashme. Po keshtu ligji shprehet se nepermjet plotesimit kriterëve te vecanta "operatorët ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, [...]". Ne kete prizem Laser Med shpk ka plotesur dhe vertetuar qofte kualifikimin teknik profesional, reputacionin, besueshmerine dhe pervojen e duhur.*

*Gjithesesi, pavaresisht sa me siper sqaruam, po rendisim argumentet perse kontratat e paraqitura nga Laser Med shpk si eksperience e ngjashme, jane te vlefshme per proceduren ku kemi marre pjese.*

*1.2 - Ne Nenin 3 te Ligji Nr. 89/2014 "Per Pajisjet Mjekesore" percaktohet si me poshte:*

*I. Ky ligj zbatohet per:*

- a) pajisjet mjekesore, aksesoret (ne vijim pajisje mjekesore);*
- b) perdoruesit profesioniste te pajisjeve mjekesore;*
- c) pajisjet mjekesore te diagnostikimit in vitro;*
- ç) pajisjet mjekesore te implantueshme aktive;*

*Ndersa po ne kete Nen, perkatesisht pika 2 e tij dhe pikat ne vazhdim percakton gamen e pajisjeve/produkteve mjekesore te cilat nuk jane objekt i ketij ligji, pra Ligji specifik per pajisjet mjekesore e ka bere ndarjen e pergjithshme te tyre, ku sipas kesaj ndarjeje edhe mallrat objekt i kontrates edhe ato te kontratave me QKTGJ perfshihen ne objektin e ligjit dhe jo ne ato qe nuk jane objekt i ligjit.*

*1.3 Pra duke u bazuar ne grupimin e bere ne Ligjin Shqiptar, mallrat/pajisjet mjekesore te kerkuara nga AK, me ato te Kontratave te realizuara me QKTGJ jane te ngjashme per aq kohe sa rregullohen prej te njejtin akt normative.*

*1.4.1 Kontratat e ngjashme, llogjikisht dhe formalisht, presupozojne mallra me specifikime teknike te ngjashme, pra, jo identike madje as dhe homogjene. Ne Ligjin e Prokurimit publik (23.3.a) percaktohet se specifikimet teknike ju referohen "standardeve kombetare, qe mbeshteten ne ato nderkombetare, miratimeve teknike nderkombetare, specifikimeve teknike te pergjithshme,*

standardeve nderkombetare apo sistemeve te tjera teknike te referimit, te percaktuara nga organet nderkombetare te standardizimit". Pervec Ligjit shqiptar sic u sqarua me lart, edhe Normativat nderkombetare te fushes i trajtojne si pajisje mjekesore te ngjashme (Klasa II). Ligji shqiptar i vitit 2014 i referohet nder te tjera nje sere aktesh te Bashkimit Europian. Edhe Akti me i fundit i botuar tek Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr. 117/1, date 05.04.2017, faqe 13-21, percaktohet si me poshte:

Per qellimet e kesaj rregulloreje, zbatohen perkufizimet e meposhtme: (1) 'pajisje mjekesore' nenkupton cdo instrument, aparat, pajisje, softuer, implant, reagent, material ose artikull tjetër i destinuar nga prodhuesi qe do te perdoret, vetem ose ne kombinim, per qeniet njerezore per nje ose me shume nga qellimet specifike mjekesore te meposhtme:

- Diagnostifikimi, parandalimi, monitorimi, parashikimi, prognoza, trajtimi ose zbutja e semundjes,
- diagnoza, monitorimi, trajtimi, lehtesimi ose kompensimi i nje demtimi ose paaftesie,
- hetimi, zevendesimi ose modifikimi i anatomise ose i nje procesi fiziologjik ose patologjik ose gjendje,
- sigurimi i informacionit me ane te ekzaminimit in vitro te ekzemplareve qe rrjedhin nga trupi i njeriut, perfshire donacionet e organeve, gjakut dhe indeve [...].

II-. Persa i perket shkakut te refuzimit te ofertes per: 'Vertetimi i debise per OSHE i paraqitur nga ju nuk eshte i sakte', gjykojme se eshte, ne rastin me te mire, lajthitje ne objekt.

Kriteri: Ofertuesi duhet te dorezoje ... Vertetimin qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi, eshte i detyrueshem ne zbatim te VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 26, pika 7/c, qe shprehimsht thote: "nje vertetim qe konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi. Mosshlyerja e detyrimeve te energjise elektrike perben shkak per skualifikimin e operatorit ekonomik, pervec rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara te energjise elektrike, te konfirmuara ne vertetimin e leshuar nga furnizuesi, jane ne proces ankimi ne gjykate".

Vertetimi i paraqitur, i leshuar nga FshU/OshEE eshte nje vertetim i vlefshem, standart dhe i unifikuar qe verteton po ashtu se Laser Med sh.p.k, nuk ka pasur detyrime te maturuara ndaj OSHE, ku thuhet se Laser Med shpk rezulton te kete ne total 0 leke detyrime per faturat e energjise elektrike, pra ploteson kushtin e DST te parashikuar ne piken 2.1.dh.

Laser Med shpk nuk percakton as formen dhe as permbajtjen e dokumentit, perkatesisht Vertetimit te Debise, dhe, per me teper, nuk egziston asnje detyrim ligjor qe operatori ekonomik pjesemarres ne tender duhet te kete domosdoshmerisht te lidhur kontrate te energjise elektrike.

Ne rast paqartesie ose dyshimi per vertetimin e leshuar prej FSHU/OSHEE kerkesa te metejshme duhet ti referohen ketij institucioni, si autoritet pergjegjes per Vertetimin e leshuar. [...]. Pavaresisht se e gjykojme te pabazuar kerkesen per sqarim tuaj, saktesojme se

*mungesa e pergjigjes ishte per shkak te afatit te shkurter te lene per pergjigje (1 dite pune) dhe mungeses se njoftimeve per kerkesen tuaj sipas Nenit 161 te Kodit te Procedurave Administrative.*

*- Persa i perket adreses se sakte ku kryhet aktiviteti i Kompanise Lasermed, ne dokumentat e dorezuara te ketij tenderi do te gjenit te shprehur qarte adresen e kerkuar, mund t' i referoheshit:*

*Vertetimit per kapacitetin ekonomik dhe financiar, dokument i kerkuar sipas DST, Kriteret e vccanta te kualifikimit, pika 2.2, ku ne permbushjen e kesaj pike, Lasermed ka paraqitur deklaratat e xhirove vjetore te viteve te fundit. Ne kete dokument, te leshuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomise eshte shprehur qarte adresa e aktivitetit; Autorizimit te leshuar prej Ministrise se Shendetesise per tregtim me shumice te materialeve mjekesore.*

*- Per dokumentacionin e dorezuar ne OShEE, e cila e ka gjetur te rregullt per leshimin e vertetimit te debise, jua dergojme bashkelidhur. Gjej me vend te sqarojme se aktiviteti (Zyra qendrore e shoqerise ne Shqiperi) e Laser Med eshte ne te njejtin objekt me shoqerine Megapharm shpk, e cila ka si numer kontrate (kod) me OShEE: TR3M110064551335.*

*Per sa siper argumentuam kerkojme kualifikimin e ofertes se Laser Med shpk.”*

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 900/1 prot., datë 27.05.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si vijon:

*“1. Ne lidhje me pretendim tuaj se jeni skualifikuar nga KVO, per mosplotesim te pikes 2.3.1 te DST ku nga AK kerkohet "Furnizime te meparshme te ngjashme ne nje vlere prej 40% te vleres se fondit limit te lotit apo shumes se loteve per te cilat konkurron, te realizuara gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave te kesaj procedure prokurimi", komisioni konstaton se furnizimet e ngjashme te paraqitura dhe dokumentuara nga ana juaj jane ne perputhje me objektin e prokurimit dhe nuk perbejne shkak per skualifikim.*

*Pretendimi juaj qendron.*

*2. Ne lidhje me arsyen e skualifikimit tuaj per mosparaqitje te vertetimit te OSHEE, ju sqarojme se Komisioni i shqyrtimit te ankesave verifikoi pretendimet tuaja, arsyeton se ju si operator pjesemarres ne kete procedure prokurimi duhet te kishit dokumentuar ne sistem app.gov.al vertetim nga OSHEE per detyrime te operatorit Megapharm shpk ne baze te kontrates huaperdorje (Neni 3 Detyrime ndaj te treteve) paraqitur nga ana juaj.*

*Pretendimi juaj nuk qendron.”*

II.6. Në datën 05.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton arsyen e skualifikimit lidhur me vërtetimin e lëshuar nga OShEE.

II.7. Në datën 17.06.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 520/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 1014/1 prot., datë 15.06.2020, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Referuar nformacionit të siguar nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet verifikimit në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) si dhe informacionit të sjellë nga autoriteti kontraktor mbi procedurën e prokurimit me Nr.REF-56393-04-17-2020, me objekt: “*Set per CT-Skaner*”, Loti 3, me fond limit 2.875.000 leke pa tvsh, zhvilluar me date 11.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan, rezulton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 18.05.2020 ka kryer rivlerësimin e ofertave, duke skualifikuar operatorin ekonomik “Laser Med” sh.p.k për disa arsye të cilat i janë bërë të njohura ankimuesit, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike në këtë datë dhe konkretisht:

1. *“Vertetimi i debise per OSHE i paraqitur nga ju nuk eshte i sakte, pasi ju si operator pjesemarres duhet te kishit dokumentuar ne vertetim nga OSHEE per detyrime te operatorit Megapharm shpk ne baze te kontrates huaperdorje (neni 3 detyrime ndaj te treteve) paraqitur nga ana juaj, duke mos plotesuar kriteret e vecanta per kualifikim te kapacitetit teknik pika 2 dh te kerkuara ne DST.*
2. *Mostra e paraqitur nga ju, sipas komisionit te testimit te mostrave nuk jane te pranueshme per perdorim ne pajisjen e injektorit te kontrastit ne Spitalin Elbasan.”*

III.1.1.Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit, si dhe nga shqyrtimi i ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues respektivisht pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se ankimuesi nuk e ka ankimuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik arsyen e skualifikimit të ofertës së tij: *“Mostra e paraqitur nga ju, sipas komisionit te testimit te mostrave nuk jane te pranueshme per perdorim ne pajisjen e injektorit te kontrastit ne Spitalin Elbasan”*. Në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi ka kundërshtuar arsyet e tjera të skualifikimit, të bëra me dije ankimuesit në datën 15.05.2020 nëpërmjet SPE, njëra prej të cilave është pranuar nga KSHA.

III.1.2. Për sa më sipër, rezulton se operatori ekonomik ankimues nuk i ka ankimuar të gjitha arsyet e skualifikimit pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit, në përputhje me nenin 63 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pika 2 , 5, 6 dhe 7 parashikohet se:

*“Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji” (pika 2).*

*“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës (pika 5).” “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor” (pika 6). “Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me formularin përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete, baza ligjore dhe përshkrimi i shkeljes, pretendimi i ankuesit për vendimin përfundimtar, shkallët e ankimit, shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor. Elementet e mësipërme janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës. Komisioni i Prokurimit Publik e shqyrton ankesën në përputhje me LPP, Kodin e Procedurave Administrative dhe rregullat e prokurimit publik. Mosndjekja e shkallëve të ankimit e bën ankesën të pavlefshme” (pika 7).”*

III.1.3. Në këto kushte, duke qënë se aktualisht kanë përfunduar afatet e ankimimit në autoritetin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit: *“Mostra e paraqitur nga ju, sipas komisionit të testimit të mostrave nuk janë të pranueshme për përdorim në pajisjen e injektorit të kontrastit në Spitalin Elbasan”,* e cila nuk është ankimuar fillimisht pranë autoritetit kontraktor dhe më pas në KPP, nuk mund të merren në shqyrtim nga ky komision e për rrjedhim ai rezulton të ngelet i skualifikuar në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Komisioni i Prokurimit Publik arsyeton se, nisur nga sa më sipër analizuar, operatori ekonomik ankimues nuk ka respektuar procedurën e ankimimit bazuar në legjislacionin për prokurimin publik fillimisht në autoritetin kontraktor dhe më pas pranë organit më të lartë në fushën e prokurimeve, Komisionit të Prokurimit Publik, pasi edhe në hipotezën se pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik “Laser Med” sh.p.k., pranë Komisionit të Prokurimit Publik do të qëndronin, operatori ekonomik ankimues nuk do të ndryshonte gjendjen e tij faktike e juridike, por do të mbetej sërish i skualifikuar nga procedura në fjalë, për arsyen e skualifikimit, të cilën nuk e ka ankimuar pranë autoritetit kontraktor dhe KPP-së, në respekt të shkallëve të ankimimit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”,* i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,* Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,



## **Vendos**

1. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Laser Med” sh.p.k, për procedurën e prokurimit me Nr.REF-56393-04-17-2020, me objekt: “*Set per CT-Skaner*”, Loti 3, me fond limit 2.875.000 leke pa tvsh, zhvilluar me date 11.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 520 Protokolli**

**Datë 05.06.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**